



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

2024

RAPORT

MBI MONITORIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME LOKALE, PËR KRYETARIN E BASHKISË HIMARË



**UK International
Development**

Partnership | Progress | Prosperity

RAPORT PËRFUNDIMTAR
MBI MONITORIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME LOKALE, PËR
KRYETARIN E BASHKISË HIMARË

Publikuar në 10 Gusht 2024

Autor: Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Përgatiti:

Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Z. Emanuel Xhindi, Asistent ligjor dhe Asistent projektsh, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Ky raport është hartuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), në kuadër të zbatimit të projektit “Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike: Forcimi i rolit monitorues dhe kërkesës së llogarisë nga qytetarët nëpërmjet shoqërisë civile, medias dhe mbështetjes akademike”, financuar nga Ambasada Britanike në Tiranë dhe zbatuar në partneritet me Instituti i Studimeve Politike (ISP), Qëndresa Qytetare dhe BIRN Albania.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk përcjell domosdoshmërisht pikëpamjet e Ambasadës Britanike.

Nëse jeni të interesuar për këtë raport, mund të kontaktoni Komitetin Shqiptar të Helsinkit në adresën e mëposhtme:

Rr. Brigada e VIII, Pallati “Tekno Projekt” Shk 2 Ap 10, Tirana-Albania
PO BOX no.1752;
Tel: 04 2233671;
Cel: 0694075732;
E-mail: office@ahc.org.al;
Web site: www.ahc.org.a

Hyrje

Me dekretin nr. 244, të datës 5 Korrik 2024, Presidenti i Republikës së Shqipërisë caktoi datën 4 Gusht 2024 për zhvillimin e zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë.

Në përputhje me misionin e tij, për të kontribuar në drejtim të garantimit të zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, me një ekip prej 6 vëzhguesish afatgjatë, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) u angazhua në monitorimin e këtyre aspekteve të procesit zgjedhor:

- a. Vlerësimin e integritetit zgjedhor, duke marrë kontakt në terren me zgjedhësit, përgjatë datës 2 Gusht 2024 dhe duke bashkëbiseduar me ta nëse ka patur apo jo ndikime që cenojnë lirinë, barazinë dhe fshehtësinë e votës.
- b. Vëzhgimin e respektimit të heshtjes zgjedhore si dhe procesit të dorëzimit të materialeve nga KZAZ-ja e Bashkisë së Himarës drejt KQV-ve, përgjatë datës 3 Gusht 2024.
- c. Procesin e votimit në 44% të Qendrave të Votimit (QV), 14 prej të cilave në fshatrat në Qeparo¹, Borsh², Piqeras³, Lukovë⁴, Himarë “Fshat”⁵ dhe katër qendrat brenda perimetrit të qytetit të Himarës⁶.
- d. Vëzhgimin e pjesshëm në kohë të procesit të numërimit, deri në orët e para të mëngjesit, të datës 5 Gusht 2024.

Paraprakisht, vëzhguesit afatgjatë të KShH-së u trajnuan sipas një metodologjie që bazohet në parimin e objektivitetit, profesionalizmit dhe paanshmërisë.

Monitorimi i këtyre zgjedhjeve u realizua në kuadër të nismës “Ndërtimi i integritetit elektoral dhe qëndrueshmërisë së partive politike: Rritja e rolit mbikëqyrës dhe kërkesave të qytetarëve nëpërmjet mbështetjes së OShC-ve, mediave dhe akademisë”, mbështetur financiarisht nga Ambasada Britanike në Tiranë. Kjo nismë po zbatohet nga një konsorcium organizatash vendase, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Instituti i Studimeve Politike, Qëndresa Qytetare, BIRN Albania.

Gjetjet dhe konkluzionet e pasqyruara në këtë raport janë përgjegjësi e vetme e KShH-së dhe nuk pasqyrojnë detyrimisht opinionet dhe mendimet e organizatave të tjera partnere dhe Ambasadës Britanike në Tiranë.

Përmbledhje Ekzekutive

Në monitorimin e situatës parazgjedhore, nëpërmjet bashkëbisedimit të drejtpërdrejtë në terren, KShH vërejti se shumica e qytetarëve referoi se ndiheshin të lirë në ushtrimin e së drejtës së votës. Vlen të theksohet se një pjesë e tyre shfaqën tendenca të hezitimit për të komunikuar, në kontaktin e parë me vëzhguesit e KShH-së. Megjithatë, u përcollën edhe pretendime për shitblerje të votave në formën e të mirave materiale, shpërdorimit të asetëve publike, si dhënies së titujve të pronësisë së shtëpive, por edhe ushtrimit të presionit mbi administratën publike lokale në Bashkinë e Himarës.

¹ QV 4851/00 dhe 4581/01

² QV 4566 dhe 4566/1

³ QV4565/00 dhe 4565/01

⁴ QV 4563/00, 4563/01, 4563/02

⁵ QV 4588/00 dhe 4588/01

⁶ QV 4590/00, 4590/01, 4591/00, 4591/01

KShH vëren se çështjet e të drejtave pronësore në Bashkinë e Himarës përbëjnë një shqetësim që ka ndikuar në uljen e besimit të zgjedhësve tek e drejta kushtetuese e votës dhe sistemi demokratik i zgjedhjeve. Akoma më shqetësuese janë perceptimet e tyre se ka patur një trajtim të diferencuar të banorëve, në gëzimin dhe ushtrimin e këtyre të drejtave, në raport me shtetas që kanë përfituar në mënyrë të padrejtë ose të shpejtë, për shkak të lidhjeve me natyrë politike ose me zyrtarët publikë.

Duke qenë se praktika e zgjedhjeve po evidenton proces pas procesi, përfshi zgjedhjet e fundit në Bashkinë Himarë, angazhimin në fushatën zgjedhore të administratës publike në role koordinuese dhe influencuese në zona të ndryshme, edhe pse “në dukje” dhe “formalisht” jashtë orarit të punës, KShH vlerëson se kjo praktikë në thelb përbën shpërdorim të aseteve publike për qëllime zgjedhore, edhe pse nuk ndalohet sipas nenit 91 të Kodit Zgjedhor. Si rrjedhojë krijohet një garë e pabarabartë midis subjekteve garuese, politizim në radhët e administratës publike si dhe papajtueshmëri me detyrën e tyre në shërbim të publikut, në kuptim të nenit 4 të ligjit nr.9131, dt. 8.9.2003 “Për Rregullat e etikës në Administratën Publike”.

KShH vëren se lidhur me këto zgjedhje, nga data e dekretimit të tyre deri në dt.8 Gusht 2024, në faqet zyrtare të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Prokurorisë së Posaçme (SPAK) nuk ka patur njoftime zyrtare mbi administrimin e denoncimeve apo vendosjes në lëvizje me iniciativë për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve. Gjithashtu, mungon informacioni nëse janë marrë masa të natyrës organizative për rritjen e gatishmërisë së prokurorive përkatëse, në përputhje me fushën e tyre të kompetencës lëndore, në funksion të parandalimit dhe hetimit në kohë dhe mënyrë pro-aktive të këtyre veprave penale.

Në raport me zgjedhjet e kaluara vendore, pavarësisht se pati një respektim më të mirë të ditës së heshtjes zgjedhore të sanksionuar në nenin 77 të Kodit Zgjedhor, KShH vlerëson se prezenca e funksionarëve të lartë shtetërorë dhe promovimi në median sociale i turizmit apo fotove me kandidatin e PS-së, në Bashkinë e Himarës përbën njëkohësisht promovim të kandidatit dhe subjektit zgjedhor “Partia Socialiste”.

Nga monitorimi i ditës së votimit, vëzhguesit e KShH-së vërejtën se procesi u realizua në një klimë relativisht të qetë, me përjashtim të tensioneve që u krijuan si rrjedhojë e mosushtrimit të së drejtës së votës, të zgjedhësve nën moshën 75 vjeçare, të cilëve iu kishte skaduar vlefshmëria e dokumentit të identitetit. Trajtimi i diferencuar që u krijua për këta zgjedhës, në raport me faktin se në zgjedhjet e kaluara ishin lejuar të votonin në sajë të aktit normativ të Këshillit të Ministrave për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë kartave të identitetit, nevojitet të adresohet seriozisht dhe nuk mund të jetë një çështje që i lihet në diskrecion vetëm kërkimeve të partive politike, sipas interesave që mund të kenë për elektoratin nga një proces zgjedhor në tjetrin.

Problematikat që shoqëruan mbarëvajtjen e procesit të votimit përmbledhen në mungesën e trajnimit të Komisionerëve, veçanërisht atyre të QV-ve në fshatra, të cilat krijuan edhe disa parregullsi sikurse ishte mostimbrimi në disa raste i zgjedhësve, mosrespektimi pjesërisht i procedurës së dhënies së ndihmës për zgjedhësit që nuk votonin vetë, lejimi në afro 4 raste i zgjedhësve për të shkuar drejt dhomës së fshehtë me aparat celuar, episode sporadike të votimit familjar, vështirësitë në respektimin e procedurave të mbylljes së disa QV-ve.

Gjithashtu, edhe pse në një numër të vogël qendrash u konstatua prezencë e personave të paautorizuar në perimetrin e brendshëm rrethues të tyre, brenda rrezes 150 metra nga Qendra e Votimit që është e ndaluar me vendimmarrje të KQZ-së si dhe disponimi në telefon i aplikacioneve nga vëzhguesit partiakë që bënin të mundur identifikimin e zgjedhësve.

Në përgjithësi, reagimi i komisionerëve ndaj vërejtjeve të vëzhguesve të KShH-së ishte pozitiv, ndërkohë që këto vërejtje nuk u protokolluan në shumicën e rasteve në librin e protokollit të mbledhjeve të KQV-ve. Komisionerët reflektuan mbi shkeljet e raportuara duke përmirësuar sjelljen e tyre, në respektim të procedurës së kërkuar për ushtrimin e votës. Megjithatë, pati edhe raste sporadike të presionit ndaj vëzhguesve, sidomos kur u paraqitën vërejtje me shkrim për largimet e komisionerëve nga QV në një kohë të gjatë, pa u protokolluar. Në sajë të ndërhyrjes së KQZ-së, këto ndërhyrje mbetën të rralla.

Aksesi i zgjedhësve me aftësi të kufizuar në godinat e Qendrat e Votimit, si rrjedhojë e mungesës së rampave dhe mungesa e fletëve të posaçme të votimit për shtetasit e verbër, përbën një problematikë të përsëritur. KShH vlerëson se duhet të jenë organet e qeverisjes vendore që të marrin një rol pro-aktiv në identifikimin e këtyre shtetasve, ndërkohë që Kodi Zgjedhor kërkon që këta shtetas të vendosin në lëvizje këto organe, duke krijuar një barrë procedurale burokratike për ta.

Procesi i numërimit u administrua në një kohë shumë të shkurtër dhe në ndryshim nga zgjedhjet e kaluara, gjatë kohës së vëzhgimit nga KShH nuk pati kërkesa për pavlefshmëri të fletëve të votimit.

1. Periudha parazgjedhore

1.1. Listat e Zgjedhësve dhe ndërgjegjësimi i tyre mbi procesin

Neni 33, gërma “c” e Kodit Zgjedhor përcakton se Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor (KZAZ) duhet të afishojë në një vend të dukshëm listat e zgjedhësve. Më datë 3 gusht 2024, vëzhguesit e KShH-së kanë konstatuar se kjo kërkesë procedurale është respektuar për QV-të nr. 4590/00, 4590/01, 4591/00 dhe 4591/01. Megjithatë, në QV-në 4588/00, në Himarë Fshat, listat e zgjedhësve në ambjentet e jashtme të KQV-së ishin të pambrojtura me xham dhe u konstatuan në terren të grisura.

Vëzhguesit kanë raportuar gjatë ditës së votimit se në shumicën e rasteve, zgjedhësit nuk kanë qenë të ndërgjegjësuar për emrin e tyre në listë. Duke qenë se në një pjesë të godinave ishin vendosur disa QV, shpesh herë u konstatuan zgjedhës që shkonin sa tek njëra te tjetra, të cilët ndihmoheshin për identifikimin e Qendrës së tyre, si nga Komisionerët, operatorët e PEI por gjithashtu dhe nga vëzhguesit partiakë. Kjo e fundit, bie në kundërshtim me nenin 7 të Kodit Zgjedhor që parashikon të drejtat dhe detyrimet e tyre si dhe krijon premisa për presion dhe ndikime ndaj zgjedhësve në ushtrimin e të drejtës së votës.

1.2. Perceptimet e zgjedhësve

Metodologjia e përdorur për zhvillimin e kësaj vlerësimi u bazua në zhvillimin e takimeve me banorët të vendosur më së shumti pranë bizneseve të zonës së qytetit të Himarës si dyqane, farmaci, lokale, pika parkingu, si dhe në qendrat e fshatrave “Himarë Fshat”, “Vuno” dhe “Kuç”.

Zgjedhësit e Bashkisë Himarë që kanë trashëguar prona nga paraardhësit e tyre, shprehën shqetësim mbi problematikat për ushtrimin dhe gëzimin efektiv të së drejtës së pronës, duke i ndërlidhur problematikat me hezitimin për të ushtruar të drejtën e votës. Një prej tyre pohoi se ka pasur zvarritje në proceset e regjistrimit të pronave të paluajtshme, dhe nëse një parti do ta ndihmonte, do ishte e gatshme të votonte për të. Një zgjedhës tjetër pohoi se vitet e fundit, banorët që kanë të drejta pronësore në proces kërkimi janë diskriminuar pasi një pjesë e tokave apo pronave të kësaj Bashkie i kanë kaluar në mënyrë të privilegjuar shtetasve me influence politike dhe lidhje shtetërore. Në fshatin e Kuçit, banorët pohuan se kishin marrë, pak ditë para se të dekretoheshin zgjedhjet e pjesshme, titullin e pronësisë për shtëpitë e tyre, në një ceremoni të zhvilluar në fshatin “Dhërmi” nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë. Ndërkohë që fitimi me të drejta të plota i titujve të pronësisë mbi tokën e trashëguar në këto troje vijon të jetë në proces.

Vëzhguesit e KShH-së vërejtën se në kontaktin e parë, zgjedhësit reflektonin një qasje mosbesimi për të biseduar në mënyrë të hapur dhe të drejtpërdrejtë. Megjithatë, edhe pse në pakicë, një pjesë banorësh përmendën praninë e një atmosfere të trysnuar në administratën publike. Një prej banorëve pohoi se duke qenë një Bashki e vogël, ata e njihnin njëri tjetrin, përfshi këtu njohjet shoqërore dhe familjare me shtetas të punësuar në administratën publike të Bashkisë Himarë, të cilët ndihen të frikësuar të flasin.. Gjithashtu ai përmendi se i druhej komunikimit, pasi mund të inspektohej nga organet përkatëse dhe mund të gjobitej. Në fshatrat e vizituara u arrit të merrej kontakt i drejtpërdrejtë ose informacion mbi shtetas të punësuar në administratën publike lokale në Qarkun e Vlorës, të angazhuar në fushatën zgjedhore. Pavarësisht se ishte i vështirë identifikimi në mënyrë të qartë i atyre që quhen “patronazhistë” që veprojnë në interes të partive politike, nga bashkëbisedimi me disa prej banorëve kuptohej roli i tyre si “ndikues” apo “kontrollues” të zonave të caktuara apo mbi zgjedhësit në favor përkatësisht të dy subjekteve zgjedhore garuese.

Një pakicë banorësh pohuan se ka shitblerje votash, duke ngritur akuza në drejtim të dy subjekteve zgjedhore garuese për këto zgjedhje. Një pjese e tyre pohuan se kjo ndodhte vetëm në zonat rurale, pasi Himariotët ishin në gjendje shumë të mirë ekonomike, ndërkohë pjesa tjetër pohuan se kjo po ndodhte ditët e fundit edhe në qytet, madje edhe në ditën para votimit, ku vlerat në të holla rriteshin për të korruptuar elektoratin “gri”. Si forma të tjera të shitblerjes së votës u përmenden lejet e legalizimit, furnizimi falas me karburant, si dhe pakot ushqimore në fshatra.

1.2 Heshtja Zgjedhore

Vëzhguesit e KShH-së monitoruan përgjatë ditës së 3 Gushtit respektimin e detyrimit të heshtjes zgjedhore- kjo, një periudhë prej 24 orësh, në të cilën neni 77 i Kodit Zgjedhor parashikon se nuk lejohet asnjë lloj fushate zgjedhore nëpërmjet organeve të medias, si dhe zhvillimi i mitingjeve ose i veprimtarive të tjera zgjedhore të subjekteve zgjedhore.

Pothuajse në të gjitha zonat me akses të lartë publik në perimetrin brenda qytetit, afër institucioneve dhe në rrugët kryesore të këtij perimetri nuk u vërejtën materiale propaganduese për subjektet zgjedhore garuese dhe kandidatët e tyre, me përjashtim të dy zyrave elektorale të tyre që qëndronin të hapura dhe kishin në pjesën e fasadës së jashtme foto të kandidatëve dhe simbolet përkatëse që identifikojnë këto subjekte zgjedhore. Prezenca e funksionarëve të lartë publikë ditën e heshtjes zgjedhore në bashkinë e Himarës dhe promovimi në median sociale i turizmit apo fotove me kandidatin e PS-së përbën njëkohësisht promovim të kandidatit dhe subjektit zgjedhor përkatës, ditën kur klasa politike duhet ta respektojë heshtjen zgjedhore të sanksionuar në nenin 77 të Kodit Zgjedhor.

1.3 Transferimi i materialeve zgjedhore pranë QV

Sipas nenit 100, pika 1 të Kodit Zgjedhor, KZAZ-ja, jo më vonë se 15 orë para hapjes së votimit, u shpërndan materialet zgjedhore KQV-ve nën juridiksionin e saj. Ky afat ligor, në rastin e zgjedhjeve të pjesshme në Bashkinë e Himarës përkon me orën 16:00 të datës 3 Gusht 2024.

Me paraqitjen e kryetarëve dhe sekretarëve të 36 Qendrave të Votimit, procesi përfundoi me një vonesë relativisht të pakonsiderueshme, përkatësisht në orën 18:30. Pas shpërndarjes së disa prej kutive të materialeve zgjedhore, kryetari i KZAZ-së i kërkoi vëzhguesve të KShH-së të largoheshin nga ambientet e brendshme dhe më pas komunikoi se do të hartonte një vendim për largimin e tyre, por më vonë u tërhoq nga kjo kërkesë. Shpeshherë, anëtarët e KZAZ-së komunikonin në gjuhën greke, çka vështirësoi procesin e vëzhgimit dhe të kuptuarit nga vëzhguesit e KShH-së. Gjatë procesit të dorëzimit, vëzhguesit e KShH-së konstatuan disa parregullsi, të cilat në tërësi nuk e dëmtuan mbarëvajtjen e procesit të administrimit zgjedhor⁷.

Nga diskutimet e anëtarëve të KZAZ-së, vëzhguesit e KShH-së vërejtën se një prej anëtarëve të KQV-së nr. 4563/00 në Piqerras kishte papajtueshmëri me detyrën, për arsye të detyrës së tij si anëtar i Këshillit Bashkiak çka bie ndesh me parashikimet e nenit 37, gërma “b” e Kodit Zgjedhor.

Nga përfaqësuesit e KZAZ-së, të pranishëm gjatë vizitës monitoruese u informuam se kishte patur ndryshime në përbërje të KZAZ-së një ditë më parë, përkatësisht Sekretari përfaqësues i subjektit zgjedhor “Partia Socialiste” dhe një prej anëtarëve, përfaqësues i subjektit zgjedhor “Bashkë Fitojmë”. KShH vlerëson se ky ndryshim dy ditë para zgjedhjeve nuk i shërben qëndrueshmërisë që duhet të ketë ky organ i rëndësishëm i administrimit zgjedhor.

2. Hapja dhe fillimi i procesit të votimit

Bazuar në nenin 11 pika 1 të Kodit Zgjedhor, procesi i votimit duhej të fillonte në orën 7:00 të datës 4 Gusht 2024, por në nisje pati disa vonesa të vogla deri në 30 minuta.⁸ Shkaqet e vonesës në këto raste ishin kryesisht vështirësitë teknike për lidhjen e Pajisjes PEI, ku në një rast Komisionerët u udhëzuan nga përfaqësuesit e KQZ-së.

2.1 Prania e personave të paaautorizuar gjatë ditës së votimit

⁷ Të tilla si: a. Vulat e kryetarëve të KQV-ve nuk u zgjodhën rastësisht, por ishin vendosur paraprakisht brenda dosjeve të secilës kuti. b. Asnjë prej anëtarëve të KQV-ve nuk iu kërkua një mjet identifikimi para dorëzimit të materialeve, për shkak edhe të njohjes midis tyre. c. Kryetarja e QV 4560/00 nuk mund të paraqitej për marrjen në dorëzim të materialeve, por ato do të dorëzoheshin një personi të porositur nga ky i fundit. d. Kryetari i KZAZ-së, në disa raste u konstatua se firmoste procesverbalet e kërkuara para momentit të paraqitjes së anëtarëve të KQV-ve dhe dorëzimit fizik të tyre. e. Disa prej anëtarëve të KQV-ve (Himarë e vjetër) njoftuan anëtarët e KZAZ se nuk kishte patur punonjës të policisë në ambientet e KQV-ve në momentin e dorëzimit të materialeve.

⁸ Përkatësisht në QV 4581/00 dhe 4581/01 në Borsh, QV 4590/00 në Bashkinë e Himarës, QV 4588/00 dhe /01 në Himarë Fshat, QV.4565/00 në Piqerras.

Sipas nenit 109, pika 6 të Kodit Zgjedhor, në mjediset jashtë qendrës së votimit, në oborrin e ndërtesës, në hyrje të saj dhe në korridoret e brendshme të ndërtesës nuk lejohet prania apo grumbullimi i personave, përveç zgjedhësve që presin në radhë për të votuar. Sipas Urdhrit nr. 72, dt. 02.08.2024 të KQZ-së⁹, të gjithë personat përveç anëtarëve të KQV-së, vëzhguesve të akredituar të OJF-ve dhe medias, zgjedhësve, punonjësve të KQZ-së dhe anëtarëve të KZAZ-së, nuk mund të qëndrojnë ose grumbullohen në mjediset jashtë qendrës së votimit, në oborrin e ndërtesës, në hyrje të saj, në korridoret e brendshme të ndërtesës ku është/janë të vendosura qendrat e votimit dhe përreth tyre në një distancë rrethore me rreze më të vogël se 150 m.

Sa i takon personave të paautorizuar në QV dhe rrezen më të vogël se 150 m, rastet rezultojnë më të pakta në numër, krahasimisht me zgjedhjet e zhvilluara në të kaluarën. Konkretisht këto raste janë raportuar në QV 4563/00 dhe 4563/01 në Lukovë dhe në QV 4581/00 dhe 4581/01 në Himarë Fshat, ku janë konstatuar individë apo grup personash pa bexhë akreditimi që qëndrojnë në oborret brenda perimetrit të brendshëm të këtyre godinave, brenda rrezes 150 m. Shpeshherë, këta individë kanë qenë të shoqëruar nga persona me bexhë akreditimi, si vëzhgues partiakë apo Komisionerë. Në një nga QV-të në Piqeras është vërejtur prezenca e një zgjedhësi, i cili me justifikimin se nuk kishte emrin e tij në QV qëndronte në ambientet e saj dhe ushtronte presion tek votuesit, duke përdorur gjuhë të koduar se “*e dini për kë duhet të votoni*”.

Edhe pse nuk cilësohen persona të paautorizuar, KShH vlerëson se prezenca e zyrtarëve publikë, në perimetrin e jashtëm, në rrezen mbi 150 ku ndodhet QV krijon premisa për presion ose influencim ndaj zgjedhësve dhe familjarëve të tyre. Një prej këtyre rasteve raportohet në QV në fshatin e Borshit, ku u vërejtën tek kafja 60 m në anë të rrugës një grup zyrtarësh lokalë nga Bashkia Vlorë që pasi qëndruan aty lëvizën.

3 Përbërja e Komisioneve ditën e votimit

Nisur nga parashikimi i pikës 1 të nenit 36 të Kodit Zgjedhor, KQV përbëhet nga 7 anëtarë, ku një prej tyre ushtron detyrën e sekretarit. Më tej, pika 2 e nenit 42 të Kodit Zgjedhor përcakton se vendimet e marra nga mbledhjet e KQV-së merren *me shumicën e të gjithë anëtarëve të Komisionit*, që presupozon që duhet të ketë të paktën 4 vota në mbështetje të vendimit.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit konstaton se në QV nr. 4565/00 (Piqerras), si dhe në dy Qendra Votimi në Lukovë, komisionet përkatëse kanë pasur nga gjashtë anëtarë. Edhe pse në praktikë nuk u vërejtën praktika të mungesës së kuorumit në vendimmarrje në këto Qendra, sikurse do ishte rasti i ndarjes së barabartë të votave të anëtarëve 3 me 3, KShH vlerëson se kjo praktikë duhet të adresohet në zgjedhjet e ardhshme, qoftë nga ana e KQV-ve, ashtu edhe nga KZAZ-ja.

4 Rregullshmëria e procedurave të votimit

Për sa i takon verifikimit të emrit të zgjedhësit në listë, kontrollit të mjetit identifikues ID, nënshkrimit të zgjedhësit në listë, timbrosjes në gishtin e madh të njërës dorë, KQV-të e ngritura për Zgjedhjet e pjesshme në Bashkinë e Himarës, jo gjithmonë i kanë respektuar këto procedura. Në vlerësimin e KShH kjo ka ardhur kryesisht si rrjedhojë e mungesës së

⁹ “Për zbatimin e disa rregullave për personat e pranishëm në territorin e objekteve zgjedhore ku janë vendosur qendrat e votimit, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë himarë, të datës 4 gusht 2024”

trajtimeve. Në QV 4590 në Qytetin e Himarës, 4565/00 dhe 4565/01 në Piqeras dhe 4563/00 dhe 4563/01, Komisionerët rezultuan se ose nuk ishin trajnuar, ose trajnimi i tyre datonte në zgjedhjet e fundit të qeverisjes vendore të vitit 2023.

4.1 Identifikimi me Pajisjen PEI

Në përgjithësi, vëzhguesit e KShH-së kanë konstatuar se pajisja e identifikimit elektronik të zgjedhësve (PEI) ka funksionuar shumë mirë, me përjashtime të veçanta¹⁰. Janë raportuar raste të kartave të identitetit të zgjedhësve që iu ka përfunduar afati i vlefshmërisë, të cilat janë identifikuar nga PEI si të vlefshme. Në këto raste, zgjedhësi nuk është lejuar të votojë dhe është bërë shënimi në librin e mbledhjeve¹¹.

Kur kjo pajisje nuk bënte të mundur identifikimin e identitetit të zgjedhësit, Komisionerët kanë praktikuar votimin manual.

4.2 Timbroshja

Sipas pikës pikës 1, gërmës “b” të nenit 105 të Kodit Zgjedhor, një prej anëtarëve të KQV-së, i caktuar me vendim të këtij të fundit, kontrollon votuesin në të dyja duart, nëse është timbrosur apo jo me lëndën e posaçme.

Vëzhguesit e KShH-së kanë raportuar raste sporadike kur votuesit nuk janë timbrosur¹² ose janë timbrosur pas votimit¹³. Në QV 4563/2 në Lukovë, zgjedhësit nuk u timbrosën, por vetëm ata që nuk janë njohur nga identifikimi elektronik. Në QV 4565 në Piqeras, Komisionerët justifikuan mostimbrosjen e pesë zgjedhësve të parë me garancitë që ofron pajisja PEI për ndalimin e votimit dy herë. Pas vërejtjes së vëzhgueses së KShH-së për cenim të nenit 105/1/b të Kodit Zgjedhor, timbroshja u realizua rregullisht. Në QV-në 4591/01, një zgjedhës nuk pranoi të timbroset dhe u largua pasi nuk u lejua të votonte nga KQV. Në kundërshtim me pikën 1, gërma “dh” të nenit 105 të Kodit Zgjedhor, Komisionerët nuk mbajtën shënim identitetin e zgjedhësve.

4.3 Heqja vizë e emrit të zgjedhësve në listë dhe nënshkrimi i tij/saj përbri emrit

Sipas nenit 105/1, gërmat “c” dhe “ç” të Kodit Zgjedhor, kryetari, pasi verifikon se të dhënat e identitetit të zgjedhësit përputhen me të dhënat në listën e zgjedhësve dhe se zgjedhësi është i njëjtë me personin në dokumentin e identitetit, shënon në listën e zgjedhësve llojin dhe numrin e serisë së dokumentit të identitetit dhe i heq vizë emrit të zgjedhësit në këtë listë, më tej zgjedhësi nënshkruan në listën e zgjedhësve anash emrit të tij.

Vëzhguesit e KShH-së kanë raportuar se “heqja e vizës” së emrit të zgjedhësit në listë dhe “marrja e nënshkrimit” përbri emrit të tij/saj nuk është realizuar në rastet kur është përdorur pajisja PEI. Kjo praktikë u vërejt pothuasje në të gjitha QV-të e monitoruara nga vëzhguesit e KShH-së. KShH vëren se këto garanci procedurale nuk janë respektuar si rrjedhojë e programit të temave të trajnimit “Për operatorët e pajisjes elektronike të identifikimit (PEI, Drejtoria e Logjistikës dhe Digjitalizimit, Sektori i Zhvillimeve Digjitale manualeve orientues të KQZ-së) apo si rrjedhojë e orientimeve të dhëna nga përfaqësuesit e KQZ-së drejt Komisionerëve, gjatë procesit të votimit.

¹⁰ Kështu, në QV 4565 në Piqeras, një nga zgjedhësit e regjistruar në këtë qendër nuk identifikohet nga PEI.

¹¹ QV4563/00 në Lukovë dhe QV 4588/1 në Himarë Fshat.

¹² QV 4565/00 në Piqeras, QV 4563/00 dhe 4563/01 në Lukovë dhe QV 4588/00 në Himarë Fshat.

¹³ QV 4563/01 në Lukovë

KShH vlerëson se materialet me natyrë trajnuese apo orientuese të KQZ-së nuk duhet të tejkalojnë garancitë procedurale të ofruara nga ligji. Gjithashtu, PEI, duke qenë një pajisje elektronike ka marzhin e saj të gabimit, sikurse ka ndodhur me identifikimin e kartave të identitetit të skaduara.

4.4 Respektimi i fshehtësisë së votës

Praktika e verifikimit të identitetit të zgjedhësve me anë të numrave të tyre rendorë, prej vëzhguesve partiakë të pranishëm në QV, në disa raste është konstatuar të ndiqej me lista të printuara ose aplikacione të veçanta. Kjo praktikë, sikurse është theksuar më herët mbart premisa për influencat që mund të krijohen ndaj zgjedhësve që rezultojnë në listat partiake të subjekteve zgjedhorë dhe të dëmtojë fshehtësinë e votës.

a. Ndihma ndaj zgjedhësve që nuk votojnë dot vetë

Sipas nenit 108 të Kodit Zgjedhor, zgjedhësit, që për arsye fizike nuk janë në gjendje të kryejnë vetë procedurat e votimit, mund të kërkojnë ndihmën e një familjari ose zgjedhësi tjetër, që është në listën e zgjedhësve të asaj zone të QV-së. Para se të shënojnë në fletën e votimit, zgjedhësi “ndihmës” bën një deklaratë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së se nuk do të ndikojë në vendimin e zgjedhësit, nuk do të bëjë publike votën dhe se ai vetë nuk ka votuar për llogari të një zgjedhësi tjetër.

Rastet e dhënies së ndihmës kanë qenë relativisht të pakta, kryesisht ndaj personave të moshuar, për shkak të vështirësive të tyre në shikim. Në këto raste rezulton se është mbajtur deklaratë në librin e protokollit. Megjithatë, në QV 4565/00 në Piqeras, vëzhguesit e KShH-së kanë konstatuar një rast, të një shtetaseje që edhe pse nuk ishte në listën e zgjedhësve votoi për familjen e saj, anëtarët e së cilës ishin të verbër dhe komisioni nuk i kërkoji të bënte deklaram konform nenit 108/3 të Kodit Zgjedhor. Edhe në QV 4590/1 në qytetin e Himarës, zgjedhësi që ndihmoi nuk ishte i regjistruar në atë QV, ndërkohë që në QV 4563/00 në Lukovë, ndihmësit e zgjedhësve nuk janë kontrolluar nëse bënë pjesë në listën e asaj qendre votimi.

b. Votimi familjar

Vëzhguesit e KShH-së kanë konstatuar dy raste të votimit familjar të zgjedhësve, përkatësisht në QV 4588/00 në Himarë Fshat dhe 4563/1 në Lukovë. Në këtë të fundit, familjari u lejua të hynte vetëm në dhomën e fshehtë dhe votoi pa prezencën e zgjedhësit. Komisioni nuk respektoi asnjë procedurë dhe garanci ligjore për dhënien e ndihmës në këtë rast. Ndërkohë që një rast i votimit familjar është parandaluar nga Komisionerët në QV 4581 në Qeparo. Për rrjedhojë, votoi individualisht një prej familjarëve, ndërkohë që një prej zgjedhësve të familjes dëmtoi votën në mënyrë të dukshme dhe një tjetër u largua në shenjë demonstrimi.

c. Forma të tjera të cenimit të fshehtësisë së votës

Pika 2 e nenit 106 të Kodit Zgjedhor, përcakton se votuesi duhet të palosë fletën e votimit, para se të dalë nga dhoma e fshehtë. Në QV 4565/01 në Piqeras, pasi votuesi ka dalë nga dhoma e fshehtë, fleta e votimit është palosur nga një prej Komisionerëve dhe u hodh në kuti prej tij. Vëzhguesit e KShH-së bënë një vërejtje me shkrim, e cila nuk u regjistrua në Librin e Protokollit të Mbledhjeve.

Sipas nenit 109, pika 2 të Kodit Zgjedhor në QV nuk lejohet përdorimi i telefonisë celulare nga ana e zgjedhësit dhe zgjedhësi nuk duhet të lejohet të votojë duke mbajtur aparatën telefonikë në dorë. Fotografimi i votës i ngarkon me përgjegjësi penale zgjedhësit në bazë të nenit 327 të Kodit Penal si dhe detyron anëtarët e KQV-së që të kërkojnë ndërhyrjen e oficerëve të policisë, për të garantuar fshehtësinë e votimit.

Nga vëzhgimi rezulton se në tre raste, përkundrejt ndalimeve ligjore, zgjedhësit janë lejuar të mbajnë aparatën celular me vete në dhomën e fshehtë, edhe pse nuk provohet nëse ka patur ose jo fotografim të saj¹⁴.

Nëse zgjedhësi tenton të përdorë aparatën e telefonisë apo çdo pajisje tjetër regjistrimi në dhomën e fshehtë, referuar parashikimeve të pikës 1 të nenit 107 të Kodit Zgjedhor, fleta e votimit futet në zarfin e fletëve të dëmtuara, zgjedhësit i jepet një fletë tjetër dhe rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve. Në një rast, Komisionerët dyshuan për fotografim vote pasi dëgjuan një shkrepje në dhomën e fshehtë. Pas diskutimit në gjuhën greke midis komisionerëve dhe zgjedhësit, vota u konsiderua e pavlefshme. Lidhur me këtë rast nuk rezulton të jetë njoftuar policia, por, sekretarja kërkoi identifikimin e zgjedhësit nga operatori i PEI-t. Pasi zgjedhësi hyri sërish në QV, atij iu dha një fletë tjetër votimi.

4.5 Zgjedhësit me dokument identiteti, me afat të përfunduar të vlefshmërisë

Sipas pikës 1 të nenit 105 të Kodit Zgjedhor, zgjedhësi duhet të paraqitet para KQV-së me një dokument të vlefshëm identifikimi, çka ndër të tjera, nënkupton edhe përdorimin e dokumentit brenda afatit të tij të vlefshmërisë.

Që në orët e para të mëngjesit, vëzhguesit e KShH-së raportuan problematikën e një pjese të zgjedhësve për përfundimin e afatit të vlefshmërisë së kartave të identitetit, të cilët këmbëngulën për të votuar, pasi pretendonin se ishin lejuar edhe në zgjedhjet e kaluara. KShH vëren se vitin e kaluar, Këshilli i Ministrave ka miratuar Aktin Normativ nr. 1 të datës 27.4.2023, “Për një shtesë në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, të ndryshuar. Sipas këtij akti, afati i vlefshmërisë së letërnjoftimit elektronik të shtetasve¹⁵ që përfundon deri në datën 14 maj 2023, zgjatet deri në datën 31 maj 2023.

Komisionerët pritën lidhur me këtë situatë, orientimet në disa raste të KZAZ-së ose KQZ-së. Tensione u krijuan jo vetëm nga zgjedhësit por edhe midis vetë Komisionerëve, edhe pse vëzhguesit e KShH-së raportuan se në asnjë rast nuk janë lejuar të votojnë këta shtetas.

Edhe pse dy QV në të njëjtën godinë, në Fshat Himarë, praktika të ndryshme u ndoqën nga Komisionerët e tyre. Në QV 4588/01, u shënuar në librin e protokollit vendimi për të mos lejuar një shtetas me kartë të skaduar që të votojë, pas orientimit të dhënë nga përfaqësuesi i KZAZ. Tek qendra tjetër nr.4588/00 u mor verbalisht një vendim, me ndarje të ngushtë 4 me 3 midis anëtarëve, për të lejuar shtetasit me dokumente identifikimi të pavlefshme të votojnë, por ky vendim nuk është protokolluar në mbledhje dhe as u zbatua në praktikë.

¹⁴ Në QV në qytetin e Himarës (4590/1), në Himarë fshat (4588) dhe në Piqeras (4565). Në këtë të fundit zgjedhësi qëndroi në QV relativisht për një kohë më të gjatë se mesatarja.

¹⁵ Votues në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit që lamë pas.

Mungojnë shifrat e sakta zyrtare mbi zgjedhësit që iu ka përfunduar afati i vlefshmërisë në dokumentin e vlefshëm të identifikimit në zgjedhjet e pjesshme për kryetar Bashkie në Himarë. Deri në orën 11:00 të paradites së dt.4 Gusht, ditën e votimit, shumë prej zgjedhësve janë larguar pasi nuk janë lejuar të votojnë. Me njoftimin publik që KQZ realizoi për shtetasit mbi moshën 75 vjeç, të cilët e kanë dokumentin e identifikimit pa afat dhe rrjedhimisht mund të votojnë, anëtarët e KQV-ve reflektuan një klimë më të qetë në administrimin e procedurave të votimit dhe në marrëdhëniet midis tyre.

4.6 Infrastruktura dhe Aksesi i personave me aftësi të kufizuar në QV

Vëzhguesit e KShH-së konstatuan se në ambjentet e QV-ve të monitoruara, temperaturat ishin shumë të larta, dhe se nuk ishin marrë masa të qenësishme për ta zgjidhur këtë problem. Për më tepër, në ambjentet e QV-ve 4563/00, 4565/00, dhe 4566/00 është konsumuar duhan, duke i rënduar edhe më shumë kushtet e papërshtatshme logjistike të këtyre qendrave të votimit.

Sipas pikës 7 të nenit 108 të Kodit Zgjedhor, caktimi i qendrës së votimit dhe organizimi i saj bëhen në mënyrë të tillë që të garantojnë hyrjen dhe votimin e lirë të votuesve që janë regjistruar paraprakisht si persona që nuk votojnë dot vetë. Edhe pse sipas interpretimit të harmonizuar të pikave 6, 7 dhe 8 të nenit 109 të Kodit Zgjedhor, ky detyrim është i kushtëzuar nga kërkesa e vetë me aftësi të kufizuar për tu regjistruar si zgjedhës që nuk mund të votojnë vetë, KShH thekson se marrja e masave për sigurimin e një procesi votimi gjithëpërfshirës, është mëse i rëndësishëm për respektimin e të drejtave të shtetasve me aftësi të kufizuara. Kjo edhe në funksion të detyrimit që kanë institucionet publike por edhe ato private që ofrojnë shërbime, për respektimin e përshtatjes së arsyeshme.

Vëzhguesit e KShH-së konstatuan se një shtetas paraplegjik, i cili nuk mund të aksesonte dot vetë QV në Qeparo¹⁶, pasi në hyrje të godinës mungonte rampa. Në një prej këtyre qendrave, një shtetas i verbër u ndihmua të votojë nga shoqëruesja e tij, por nuk u relatua nga KQV nëse dinte të përdorte ose jo fletë të posaçme votimi dhe nëse këto fletë ishin në dispozicion të Komisionit¹⁷.

4.7 Mbyllja e procesit të votimit

Sipas nenit 112 të Kodit Zgjedhor, qendrat e votimit duhej të mbylleshin në orën 19:00. Vendimi për mbylljen e votimit merret vetëm pasi të kenë votuar të gjithë votuesit e pranishëm në Qendrën e Votimit, dhe shënohet në Librin e Protokollit të Mbledhjeve. Atmosfera e mbylljes së QV-ve ishte e qetë dhe pa incidente, pasi nuk pati zgjedhës në radhë që kërkuan të votonin dhe që iu refuzua votimi në orarin zyrtar të mbylljes së QV.

Në disa raste, vëzhguesit e KShH-së nuk janë lejuar ose penguar për të monitoruar plotësisht procedurat e mbylljes së QV nga ana e Komisionerëve. Pavarësisht vështirësive, në asnjë rast, vëzhguesit e KShH-së nuk kanë dalë nga QV gjatë kryerjes së këtyre procedurave.

¹⁶ Ku ishin vendosur QV-të nr. 4581/00 dhe 4581/01.

¹⁷ Sipas pikës 8, të nenit 109 të Kodit Zgjedhor, në rastin e zgjedhësve të verbër, me kërkesë të tyre, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore njofton KQZ, e cila pajis komisionet me mjete të të posaçme votimi, të cilat lejojnë zgjedhësit që të lexojnë ose të kuptojnë fletën e votimit dhe të votojnë në mënyrë të pavarur.

Kryetari, sekretari, dhe çdo anëtar tjetër i KQV-së, në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk kanë të drejtë ndezin, fikin apo shkëpusin lidhjen e kamerës me rrjetin elektrik dhe/ose të ndryshojnë pozicionin e saj¹⁸. Në kundërshtim me aktet e KQZ-së janë konstatuar raste, në të cilat kamera është fikur gjatë kryerjes së veprimeve procedurale për mbylljen e votimit. Gjithashtu, shpeshherë gjatë kësaj faze, diskutimet midis anëtarëve janë kryer në gjuhën greke, çka e bëri të pamundur kuptueshmërinë e tyre nga vëzhguesit.

Problematikat e përsëritura nga zgjedhjet e kaluara, sa i takon fazës së procedurave të mbylljes së procesit, kanë të bëjnë me mungesën e njohurive dhe paqartësitë e krijuara tek Komisionerët e QV, për veprimet procedurale që duhet të kryenin për dokumentimin e procesit dhe vendosjen e materialeve zgjedhore në kutitë e votimit, sipas nenit 112 e vijues të Kodit Zgjedhor. Në mënyrë më të theksuar, kjo problematikë u konstatua në QV 4565/01 dhe 4565/00 në Piqeras, ku një pjesë e Komisionerëve pohuan se ishin të patrajnuar.

Pika 2 e nenit 114 të Kodit Zgjedhor, përcakton se kutitë me fletët e votimit dhe materialet zgjedhore dorëzohen në Vendin e Numërimit të Votave, jo më vonë se tre orë nga mbyllja e votimit. Nga vëzhgimi i procesit, rezulton se kjo kërkesë është respektuar nga ana e KQV-ve të monitoruara.

Sipas nenit 114 të Kodit Zgjedhor, shoqërimi i kutive me fletët dhe materialet e votimit bëhet me automjet, ku brenda këtij duhet të jetë kryetari dhe sekretari i KQV-së, si dhe një efektiv i Policisë së Shtetit, i cili duhet të garantojë paprekshmërinë e kutive. Në QV nr. 4588/00, punonjësi i policisë e ka shoqëruar makinën me motorr, duke mos qenë brenda automjetit.

5 Numërimi i votave

Vëzhguesit e KShH-së vijuan monitorimin e pjesshëm të procesit të numërimit, në ambientin e të vetmit vend të numërimit të votave (VNV), pranë stadiumit të qytetit të Himarës. Ky vëzhgim u shtri deri në orën 02:20, të datës 5 Gusht 2024. Para se të fillonte numërimi, në orën 11:00 të natës së dt.4 Gusht 2024, u realizua trajnimi i anëtarëve të Grupeve të Numërimit të Votave (GNV), çka përbën një problematikë të përsëritur, e kritikuar më herët në monitorimet e mëparshme nga KShH.

Në orën 00:20 të dt.5 Gusht nisi procesi i numerimit. Gjatë këtij procesi, numëruesit nuk respektonin procedurën e leximit sipas radhës apo kohën e nevojshme për vëzhguesit e pranishëm, të shfaqjes së fletës së votimit, në mënyrë të plotë dhe qartësisht të lexueshme, nga të dyja anët. Kjo praktikë krijoi një tension tek vëzhguesit e pranishëm në sallë. Vëzhguesit e KShH-së nuk vërejtën raste të kontestimit të vlefshmërisë së fletëve të votimit nga vëzhguesit partiakë. Gjithashtu, u konstatuan fletë votimi bosh ose me shënime dhe shtesa emrash, të cilat u deklaruan të pavlefshme. Ndërkohë, në tre raste, GNV-të kërkuan ndërhyrjen e KZAZ për të përcaktuar vlefshmërinë e votës.

Gjatë numërimit nuk u shënuan incidente, por vetëm disa thirrje të KZAZ për ruajtjen e qetësisë, për shkak të sipërfaqes së kufizuar të vendit të numërimit. Ashtu siç është evidentuar edhe gjatë procesit të votimit edhe në vendet e numërimit të votave është konstatuar në disa raste, prezenca e personave të paautorizuar në brendësi të ambientit të VNV-së. Vendosja në formë të dukshme e bexhave të akreditimit u respektua vetëm nga ana e vëzhguesve të organizatave jofitimprurëse vendase apo atyre ndërkombëtare.

¹⁸ Sipas 4 të nenit 19 të Vendimit të KQZ-së nr. 11, dt. 25 Mars 2021”Për mënyrën e ngritjes, organizimit, funksionimit të komisionit të qendrës së votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit”.

Në një kohë shumë të shpejtë, prej afro 7 orësh, procesi numërimit përfundoi në të vetmen KZAZ të Bashkisë Himarë.

5 Rekomandime

Zgjedhjet për Kryetar në Bashkinë Himarë vërtetuan sërish se anëtarët e Komisioneve Zgjedhore lokale, në mjaft raste nuk ishin në nivelin e duhur profesional. Në zgjedhjet e ardhshme parlamentare të vitit 2025, KQZ duhet t'i kushtojë një vëmendje më të shtuar trajnimit cilësor të Komisionerëve të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve si dhe monitorimit dhe vlerësimit të këtyre trajnimeve për të testuar njohuritë e përfuara prej Komisionerëve.

Në punën e Komisionerëve lokalë u vërejt edhe njëanshmëria partiake, ndaj KShH i sugjeron Kuvendit, kur të nisë procesin e mirëfilltë të reformës zgjedhore, ta realizojë atë në një klimë transparente dhe gjithëpërfshirëse, duke marrë në shqyrtim të gjitha rekomandimet prioritare të OSBE/ODIHR-it, përfshi këtu rekomandimin për depolitizimin e plotë të të gjithë administratës zgjedhore.

KShH i rekomandon Kuvendit të Republikës së Shqipërisë rishikimin dhe zgjerimin e fushës së veprimit të nenit 91, pika 2 të Kodit Zgjedhor, i cili ndalon vetëm përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, duke lejuar angazhimin e administratës publike, formalisht jashtë orarit, në role koordinuese dhe influencuese në zona të ndryshme ku ata vlerësohet se kanë ndikim. Në vlerësimin e KShH-së, situata të tilla krijojnë konflikte të rënda të interesit dhe në thelb përbëjnë shpërdorim të administratës publike për qëllime zgjedhore.

KShH i sugjeron Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Posaçme të realizojnë transparencë për publikun nëse ka patur ose jo një angazhim më të shtuar të prokurorive, sipas kompetencave të tyre lëndore, në identifikimin dhe hetimin e praktikave të krimit zgjedhor për zgjedhjet për Kryetar në Bashkinë Himarë. KShH ripërsërit rekomandimin e mëhershëm se organi përgjegjës i prokurorisë, në përputhje me fushën e kompetencës lëndore duhet t'i japë përparësi hetimit pro-aktiv me iniciativë, në mënyrë të plotë, të gjithëanshëm dhe objektiv, të pretendimeve për vepra penale për korrupsionin zgjedhor, ndikimeve të paligjshme në vullnetin e zgjedhësve apo shpërdorimit të aseteve publike dhe shpërdorimit të detyrës nga ana e Komisionerëve. Perceptimet, edhe pse të paprovuara apo të padenoncuar të publikut mbi këto vepra penale ulin besimin e elektoratit në sistemin demokratik të zgjedhjeve dhe integritetin e tij.

I rekomandojmë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, referuar të dhënave anonime që KShH ka marrë nga zgjedhësit nga kontakti në terren me ta, bazuar në nenin 123/3 të Kodit Zgjedhor të ngarkojë administratën e tij për të realizuar një hetim administrativ, nëse ka patur procedura të lidhura me të drejtat pronësore, duke përfshirë këtu legalizimet apo dhënien e lejeve të ndërtimit (por jo vetëm), për banorë në Bashkinë e Himarës, afër dhe gjatë periudhës së ndalimit të përdorimit të burimeve publike për zgjedhjet e pjesshme të dt.4 Gusht 2024¹⁹.

¹⁹ Gjithashtu, sipas nenit 123/1 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja vihet në lëvizje edhe kryesisht, kur ka të dhëna të cilat janë të verifikueshme pranë organeve përgjegjëse që administrojnë procedurat e trajtimit dhe regjistrimit të pronës, dhënies së lejeve të legalizimit apo ndërtimit.

Nëse vërehen elementë të veprës penale nga ky hetim administrativ, sipas nenit 328/a/4 të Kodit Penal, i sugjerojmë KQZ-së t'ja bëjë me dije organin përgjegjës të Prokurorisë²⁰.

I rekomandojmë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile që bazuar në frymën e kompetencave të parashikuara në nenet 44 e në vijim të Kodit Zgjedhor të mbikëqyrë procesin e hartimit të ekstrakteve periodikë të përbërësve zgjedhorë dhe listave përfundimtare të zgjedhësve, duke përpunuar informacione të natyrës statistikore, mbi vlefshmërinë e dokumentave biometrikë të identitetit të zgjedhësve. Këto të dhëna statistikore, të ndara sipas Bashkive vlerësojmë se duhet t'i përcillen KQZ-së në kohë (e cila mund ti kërkojë edhe me iniciativën e saj), me qëllim që të realizohet një edukim dhe ndërgjegjësim i zgjedhësve sa më cilësor dhe i orientuar sipas nevojave, në përputhje me kompetencat që KQZ ka sipas nenit 19/1/g (për ndërgjegjësimin) dhe nenit 61 të Kodit Zgjedhor (për mbikëqyrjen e listave).

I rekomandojmë Ministrin të Brendshëm dhe KQZ që praktikën e propozimit të miratimit të aktit normativ për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së njoftimeve në funksion të procesit të votimeve në interes të zgjedhësve, të mos e mbështesin vetëm mbi bazën e kërkesave të subjekteve zgjedhore, por në nevojën dhe interesin më të lartë publik për pjesëmarrje sa më të lartë në zgjedhje. Në krijimin e praktikave të tilla është e rekomandueshme të ketë edhe konsultim të gjerë me subjektet garuese.

²⁰ Përdorimi nga një punonjës që kryen një detyrë shtetërore, i të mirave publike, funksionit ose veprimtarisë shtetërore, ose i burimeve financiare ose njerëzore, me qëllim favorizimin e një partie politike ose kandidati në zgjedhje, përbën veprën penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në tre vjet.